



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

PËR

**PROCEDURËN, DOKUMENTACIONIN, KUSHTET DHE MËNYRËN E ZBATIMIT
TË NDRYSHIMEVE TË FORMËS SË FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT**

Miratuar me Vendim Bordi nr. 174, datë 08.10.2024

**Neni 1
Objekti**

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e procedurës, dokumentacionit, kushteve dhe mënyrën e zbatimit të ndryshimeve të formës së fondeve të pensionit privat.

**Neni 2
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të nenit 132, pika 6, të ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”.

**Neni 3
Përkufizime**

Termet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në ligjin nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, këtu e në vijim “Ligji”.

Neni 4

Fusha e zbatimit

Shoqëritë administruese të fondeve të pensionit privat, të licencuara sipas ligjit, zbatojnë procedurën, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore në të gjitha rastet e bashkimit, ndarjes dhe shndërrimit të fondeve të pensionit privat nën administrimin e tyre.

Neni 5

Parime të përgjithshme

1. Fondi i pensionit privat mund të ndahet në dy ose më shumë fonde ose mund të bashkohet me një ose më shumë fonde të tjera të administruara nga e njëjta shoqëri administruese ose nga shoqëri administruese të ndryshme.
2. Fondi me pjesëmarrje të mbyllur mund të bashkohet me një fond tjetër me pjesëmarrje të mbyllur ose me pjesëmarrje të hapur, ndërsa fondi me pjesëmarrje të hapur mund të bashkohet vetëm me një fond me pjesëmarrje të hapur.
3. Fondi me pjesëmarrje të mbyllur mund të shndërrohet në një fond me pjesëmarrje të hapur.
4. Fondi me pjesëmarrje të hapur mund të ndahet në dy ose më shumë fonde me pjesëmarrje të hapur, ndërsa fondi me pjesëmarrje të mbyllur mund të ndahet në fonde me pjesëmarrje të hapur ose fonde me pjesëmarrje të mbyllur.

Neni 6

Bashkimi i fondeve

1. Nëse dy ose me shumë fonde me pjesëmarrje të mbyllur bashkohen, fondi i ri që rezulton nga bashkimi mund të jetë një fond me pjesëmarrje të mbyllur, ose një fond me pjesëmarrje të hapur.
2. Nëse dy ose me shumë fonde me pjesëmarrje të hapur bashkohen, fondi i ri që rezulton nga bashkimi duhet të jetë një fond me pjesëmarrje të hapur.
3. Nëse dy ose me shumë fonde me pjesëmarrje të mbyllur dhe me pjesëmarrje të hapur bashkohen, fondi i ri që rezulton nga bashkimi duhet të jetë një fond me pjesëmarrje të hapur.
4. Dy ose më shumë fonde mund të bashkohen nëpërmjet:
 - a) kalimit të të gjitha aktiveve dhe të drejtave e detyrimeve të njërit ose më shumë fondeve (fondi transferues), tek një fond tjetër ekzistues që quhet fondi përthithës (fondi marrës). Ky proces quhet bashkim me përthithje.

- b) krijimit të një fondi të ri, tek i cili kalohen të gjitha aktivet dhe të drejtat e detyrimet e fondeve ekzistuese (fondeve transferuese), që bashkohen. Ky proces quhet bashkim për krijimin e një fondi të ri (fondi marrës).
5. Në rastin e bashkimit të fondeve me pjesëmarrje të mbyllur, shoqëria/shoqëritë administruese e fondit/fondeve transferues së bashku me kërkesën për miratimin e bashkimit, paraqet dhe pëlqimin/dakordësinë e sponsorit/sponsorave për bashkimin e synuar.
 6. Kërkesa për bashkimin e fondeve dhe dokumentacioni sipas nenit 135 të Ligjit dhe kësaj rregulloreje, paraqiten pranë Autoritetit nga përfaqësuesi i shoqërisë/shoqërive administruese.

Neni 7

Marrëveshja e bashkimit të fondeve dhe opinionin e depozitarëve

1. Në rastin e bashkimit të fondeve të pensionit që administrohen nga shoqëri administruese të ndryshme, shoqëritë administruese që administrojnë fondin transferues dhe fondin marrës janë të detyruara të hartojnë një marrëveshje bashkimi në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 136, të Ligjit. Autoriteti nëse e çmon të nevojshme, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë.
2. Në rastin e bashkimit të fondeve të pensionit që administrohen nga e njëjta shoqëri administruese, në zbatim të kërkesave të nenit 136 të Ligjit, kërkesa për bashkim duhet të shoqërohet me një plan bashkimi, i cili duhet të përmbajë të paktën:
 - a) një përshkrim të shkurtër të arsyes që çoi në bashkimin e fondeve;
 - b) përshkrimin e pasojave të parashikueshme të bashkimit për anëtarët e fondit transferues dhe fondit marrës;
 - c) përshkrimin e metodës së vlerësimit të aktiveve dhe pasiveve të fondit transferues dhe fondit marrës në datën e llogaritjes së normës së zëvendësimit (*replacement ratio*);
 - d) përshkrimin e metodës që do të përdoret për llogaritjen e normës së zëvendësimit;
 - e) datën e synuar të bashkimit.
3. Depozitarët e fondeve, që marrin pjesë në procedurën e bashkimit, në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, përgatisin një opinion si dhe deklaratën sipas parashikimeve të nenit 137, të ligjit, për shoqëritë administruese të fondit transferues dhe fondit marrës, të cilat synojnë bashkimin. Në rastin e bashkimit të fondeve të pensionit që administrohen nga e njëjta shoqëri administruese, depozitari i fondeve që synojnë të bashkohen përgatit opinionin si dhe deklaratën.

Neni 8

Ndarja e fondeve

1. Një fond me pjesëmarrje të hapur mund të ndahet në dy ose më shumë fonde me pjesëmarrje të hapur. Një fond me pjesëmarrje të mbyllur mund të ndahet në dy ose më shumë fonde me pjesëmarrje të mbyllur ose në dy ose më shumë fonde me pjesëmarrje të hapur.
2. Ndarja e fondit të pensionit kryhet kur të gjitha të drejtat dhe detyrimet e një fondi pensioni transferohen në dy ose më shumë fonde dhe fondi ekzistues priset pa likuidim. Ndarja e fondit e cila kryhet duke:
 - a) transferuar të gjitha aktivet dhe të drejtat e detyrimet në dy ose më shumë fonde ekzistuese, është ndarje me marrje në dorëzim;
 - b) transferuar të gjitha aktivet dhe të drejtat e detyrimet në dy ose më shumë fonde, të krijuar për qëllim të ndarjes, është ndarje me themelim.
3. Në rastin e ndarjes së fondit me pjesëmarrje të mbyllur, shoqëria administruese përveç kërkesës për miratimin e ndarjes së fondit, i paraqet Autoritetit dhe pëlqimin/dakordësinë e sponsorit të fondit të mbyllur për ndarjen e synuar.
4. Kërkesa për ndarjen e fondeve dhe dokumentacioni sipas nenit 135, të Ligjit dhe kësaj rregullore, paraqiten pranë Autoritetit nga përfaqësuesi i shoqërisë administruese.

Neni 9

Marrëveshja e ndarjes të fondeve dhe opinioni i depozitarëve

1. Në rastin e ndarjes së fondit të pensionit në dy ose më shumë fonde që do të administrohen nga shoqëri administruese të ndryshme, shoqëritë administruese të përfshira në proces janë të detyruara të hartojnë një marrëveshje në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashikuara në nenin 136, të Ligjit. Autoriteti nëse e çmon të nevojshme, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë.
2. Në rastin kur fondi i pensionit që ndahet do të administrohet nga e njëjta shoqëri administruese, në zbatim të kërkesave të nenit 136 të Ligjit, kërkesa për ndarje duhet të shoqërohet me një plan ndarje, i cili duhet të përmbajë të paktën:
 - f) një përshkrim të shkurtër të arsyes që çoi në ndarjen e fondeve;
 - g) përshkrimin e pasojave, të parashikueshme, të ndarjes për anëtarët e fondit;
 - h) përshkrim të metodës së vlerësimit të aktiveve dhe pasiveve të fondit që synon të ndahet dhe datën e llogaritjes së normës së zëvendësimit (replacement ratio);
 - i) përshkrimin e metodës që do të përdoret për llogaritjen e normës së zëvendësimit;
 - j) datën e synuar të ndarjes.

3. Depozitarët e fondeve, që marrin pjesë në procedurën e ndarjes, në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri, përgatisin një opinion si dhe deklaratën sipas parashikimeve të nenit 137, të Ligjit, për shoqëritë administruese të fondit ekzistues dhe fondit marrës, të përfshira në procesin e ndarjes. Në rastin kur fondi i pensionit që ndahet do të administrohet nga po e njëjta shoqëri administruese, depozitari i fondit që synon të ndahet përgatit opinionin si dhe deklaratën

Neni 10

Shndërrimi i fondit të pensionit privat

1. Shndërrimi i formës së fondit të pensionit privat behet vetëm për rastet e parashikuara në nenin 132, të Ligjit.
2. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit, përveç kërkesës për miratimin e shndërrimit të një fondi me pjesëmarrje të mbyllur në një fond me pjesëmarrje të hapur, depoziton dokumentacionin e parashikuar në pikën 2, të nenit 135 të Ligjit, si dhe i paraqet Autoritetit pëlqimin/dakordësinë e sponsorit të fondit me pjesëmarrje të mbyllur për shndërrimin e synuar.
3. Kërkesa për shndërrimin e formës së fondit dhe dokumentacioni sipas nenit 135 të Ligjit dhe kësaj rregulloreje, paraqiten pranë Autoritetit nga përfaqësuesi i shoqërisë administruese.

Neni 11

Norma e zëvendësimit

1. Pas procesit të bashkimit të fondeve anëtarët e fondit transferues do të marrin kuota në fondin marrës, në përputhje me raportin për llogaritjen e normës së zëvendësimit të përcaktuar në marrëveshjen e bashkimit.
2. Pas procesit të ndarjes, anëtarët e fondit që ndahet do të marrin kuota në fondet marrëse dhe/ose fondet e reja në proporcion me kuotat që u përkisnin në fondin që u nda, në përputhje me raportin për llogaritjen e normës së zëvendësimit të përcaktuar në planin e ndarjes.
3. Pas procesit të shndërrimit, anëtarët e fondit me pjesëmarrje të mbyllur, të cilët janë pjesë e shndërrimit të formës së fondit, në një fond me pjesëmarrje të hapur, do të marrin kuota në fondin e ri në përpjesëtim me kuotat që i përkisnin në fondin e mbyllur që shndërrohet.

Neni 12

Procesi i aplikimit

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, depoziton në Autoritet, kërkesën për miratimin e bashkimit, ndarjes apo shndërrimit të fondit të pensionit privat.
2. Kërkesa duhet të jetë e shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e parashikuar në nenin 135 të Ligjit dhe në këtë rregullore.
3. Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose kopje e noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga një institucion i huaj, dokumentacioni duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Në çdo rast Autoriteti mund të kërkojë informacion dhe dokumenta shtesë, nëse e gjykon të arsyeshme.
5. Shoqëria aplikuese për bashkim, ndarje apo shndërrim është përgjegjëse për vërtetësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të dorëzuar në Autoritet.

Neni 13

Procedura dhe afati i trajtimit të kërkesës

1. Me depozitim të kërkesës për miratimin e bashkimit, ndarjes apo shndërrimit të fondit të pensionit privat, Autoriteti brenda 10 (dhjetë) ditëve pune pas marrjes së kërkesës, shqyrton dokumentacionin e dorëzuar sipas parashikimeve në Ligj.
2. Nëse dokumentacioni i dorëzuar nuk është i plotë, Autoriteti i kërkon me shkrim ose në mënyrë elektronike shoqërive administruese të plotësojë dokumentacionin e munguar brenda 10 ditë pune.
3. Nëse shoqëria administruese, për arsye të justifikuara, nuk është në gjendje të plotësojë dokumentacionin e munguar, Autoriteti mund të shtyjë afatin për plotësimin e dokumentacionit të munguar, deri në 20 ditë pune.
4. Pas plotësimit të dokumentacionit, Autoriteti shprehet brenda 3 (tre) muajve në lidhje me miratimin e bashkimit, ndarjes apo shndërrimit të fondit të pensionit privat.

Neni 14
Miratimi nga Autoriteti

1. Bashkimi, ndarja dhe shndërrimi i fondeve të pensionit privat bëhet vetëm me miratimin e Autoritetit.
2. Autoriteti refuzon kërkesën për bashkim, ndarje dhe shndërrim të formës së fondeve, nëse vlerëson se ndryshimi i synuar do të jetë në dëm të anëtarëve të fondit ose kur konstaton se nuk përmbushen kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në ligj dhe në këtë Rregullore.

Neni 15
Detyrimi për informim

1. Shoqëria administruese e cila merr pjesë në procesin e bashkimit, ndarjes apo shndërrimit të fondit të pensionit privat është e detyruar të njoftojë me shkrim anëtarët e fondit në një nga mënyrat e mëposhtme:
 - a) me postë;
 - b) në formë elektronike përmes e-mail.
2. Shoqëria administruese është e detyruar të informojë anëtarët e fondit për planin e bashkimit, ndarjes apo shndërrimit, pasi është dhënë miratimi paraprak nga Autoriteti dhe të paktën 30 (tridhjetë) ditë pune para se të hyjë në fuqi vendimi për ndryshimin e formës së fondit, në mënyrë që anëtarët të vlerësojnë pasojat e ndryshimit të formës së fondit në llogaritë e tyre të fondit të pensionit privat.
3. Shoqëria administruese publikon njoftimin në faqen zyrtare të internetit.

Neni 16
Regjistrimi i fondit të pensionit privat

Pas përfundimit të procedurës për ndryshimin e formës së fondit të pensionit, Autoriteti pasqyron ndryshimet përkatëse në regjistrin e fondeve sipas rregullores nr. 143, datë 28.08.2024 “Për mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrave të subjekteve të licencuara, autorizuar, njohura, regjistruara dhe miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.